



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2023-012

Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës- Mejreme Memaj, bazuar në nenin 9 par.1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga avokati N.H., për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë – A.B., dhe gjyqtarës së kësaj gjykate A.M., me 20 qershor 2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paraqitur nga avokati N.H. ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë – A.B., dhe gjyqtarës A.M..

A r s y e t i m

Ankuesi N.H., i është drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës me kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë – A.B., dhe gjyqtarës A.M., të cilën kërkesë Këshilli Gjyqësor konform dispozitës së nenit 9 par.1 nënpar.1.2 të Ligjit nr.06/L-057 “Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”, me 14.06.2023 ia ka përcjellë autoritetit kompetentë U.D. Kryetares së Gjykatës Supreme..

Parashtruesi i ankesës pretendon se tek gjyqtarja A.M., gjendet lënda C.nr.952/2022 ku paditës është S.P., për të cilën është i autorizuar, dhe paditës është E.,-Pejë, për kompensim dëmi, e cila lëndë është kthyer sipas ankesës nga Gjykata e Apelit në rigjykim. Tek e njëjta gjyqtare gjendet edhe lënda C.nr.1360/2018, ku paditës është R.L., kurse e paditur K.-i në Pejë. Që të dy lëndët gjenden tek kjo gjyqtare dhe kryetari i gjykatës as që merret me disiplinimin e gjyqtarëve dhe i len ta shkelin ligjin me dy këmbë. Kërkon që të merren masa disiplinore ndaj gjyqtarës dhe kryetarit ngase ai të gjitha keqpërdorimit e gjyqtarëve i mbulon, anarki, përgjegjësi ndaj ligjit. Ankesës ia ka bashkëngjitur kërkesën drejtuar kryetarit për caktim të lëndës C.nr.952/22 datë 25 maj 2023 dhe kërkesën drejtuar gjyqtarës për vazhdimin e procedurës datë 28 shkurt 2023.

Me qëllim të vërtetimit bazës së arsyeshme siç kërkohet me ligj të pretendimeve sa i përket shkeljeve disiplinore si autoritet kompetent kam kërkuar nga kryetari i gjykatës dhe gjyqtarja që të deklarohen lidhur me këtë rast dhe kam pranuar deklaratat e tyre.

Në deklaratën e tij kryetari A.B., thekson se çështja e caktimit dhe mbajtjes së seancave gjyqësore është kompetencë e gjyqtarit të ngarkuar me lëndë, dhe për caktimin e lëndëve gjyqtarët veprojnë konform afateve të caktuara me ligj, varësisht nga lloji dhe natyra e lëndës, si dhe konform Strategjisë së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025 dhe nuk është në kompetencë të tij si kryetar të ndërhyj në aspektin e menaxhimit të lëndëve. Sa i përket lëndës C.nr.952/2022 avokati me 12.04.2023 i është drejtuar me kërkesë për caktim të kësaj lëndë nga ana e gjyqtares. Me përgjigjen GJ.A.nr.101/2023 datë 13.04.2023 avokatin e ka njoftuar se me 7.12.2022 gjyqtarja ka kërkuar përjashtim nga gjykimi i lëndës C.nr.952/2022, e meqenëse ai dhe nënkryetarja e gjykatës janë përjashtuar nga vendosja lidhur me kërkesat e avokatit, komplet lënda është dërguar në Gjykatën e Apelit për vendosje nga ana e kryetarit të Gjykatës së Apelit. Sa i përket pretendimeve tjera konsideron se ato janë dukshëm joserioze, të pabazuara, të paqarta dhe të përgjithësuara prandaj propozon që ankesa të refuzohet. Deklaratës ia ka bashkëngjitur përgjigjen që ia bërë avokatit.

Kurse, gjyqtarja A.M., në deklaratën e saj thekson se se sa i përket lëndës C.nr.1360/18 të paditësit R.L., kundër të paditurve K., dhe komuna e Pejës, në seancën e shqyrtimit gjyqësor datë 12.10.2021, paditësi personalisht ka deklaruar se avokati i tij N.H., për momentin nuk është duke punuar si avokat, por për këtë rast do të mund të siguroj prova personalisht dhe do të paraqitet në komunë për ndonjë marrëveshje dhe ka propozuar që procedura të ndërpritet deri në zgjedhje të këtij problemi, andaj konfrom nenit 278 par.1 pika a) të LPK ka marrë aktvendim për ndërprerje të procedurës, me konstatimin se në këtë çështje procedura do të vazhdoj pasi njëra palë ndër gjyqësore të kërkoj vazhdimin e saj. Lënda është dorëzuar në zyrën për menaxhimin e lëndëve civile dhe nuk ka njohuri se është parashtruar kërkesë për vazhdim të procedurës. Sa i përket lëndës C.nr.952/2022 ka kërkuar përjashtimin nga gjykimi dhe vendosja dhe lëndën ia ka përcjell kryetarit për vendosje. Nuk ka asnjë lëndë ku i autorizuar i palës është avokati N.H., për shkak se i njëjti ka parashtruar padi ndaj tij dhe në të gjitha rastet ka kërkuar përjashtimin e saj nga lëndët e tij. Kërkon që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklaratës së kryetarit dhe gjyqtares së çështjes dhe provave të cilat ia kanë bashkëngjitur deklaratave, vlerësoj se në rastin konkret nuk ka vend për të hapur procedurë disiplinore.

Në fakt ankesa është dukshëm joserioze, ngase nuk kemi një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur ankesa për shkelje disiplinore të kryer nga kryetari i gjykatës dhe gjyqtares.

Pastaj, ankesa në rastin konkret ka të bëjë me mos caktim të lëndëve ku në një lëndë gjyqtarja e çështjes ka kërkuar përjashtimin e saj, kurse për tjetrën me kërkesë të palës është ndërprerë procedura. Pra, vlerësoj se nga ankesa e paraqitur nuk rezulton asnjë dyshim se Kryetari i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe gjyqtarja A.M., të këtë kryer ndonjë nga shkeljet disiplinore.

Nga arsyet e cekura, e në bazë të nenit 9 par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 7 par.3 nënpar. 3.2 të Rregullores së KGJK-së,

nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Mejreme Memaj
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë,
3. Nënkryetares së Gjykatës Themelore në Pejë
4. Parashtruesit të ankesës
5. Arkivit të Gjykatës Supreme.